



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:264528
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05487037

PKR.nr.14/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, kryetarja e trupit gjykues Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e praktikantes Donita Osmanollaj, në çështjen penale të akuzuarit M.B., nga Prizreni, me numër personal, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074, inicuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda nën nr. PP/I.nr.182/2023, të datës 26.02.2024, pas mbajtjes së seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, mbajtur në praninë e prokurorit të shtetit Petrit Kryeziu, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij Avokat J.R., nga Prizreni, me datë 18.03.2024, publikisht mori dhe shpalli, ndërsa më datë 21.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.B., me nofkën, nga i ati dhe e ëma e lindur, i lindur me datënë Prizren, ku edhe tani jeton rruga “.....” nr., ka të kryer shkollën fillore, frizer, i pa martuar, me numër personal, me adresë elektronike, turk, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendjes së dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Më datë 30.11.2023 rreth orës 21:30 minuta, në shtëpinë e tij të banimit e cila gjendet në rrugën “Suzi Qelebi” në Prizren, pa autorizim e me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes, posedon substanca të cilat me ligj janë shpallur si narkotikë dhe atë substancën narkotike të llojit marihuanë, të cilën nuk arrin ta shpërndajë dhe ta shesë pasi që ndërhyjnë policia dhe sekuestron substancën në fjalë. Pasi që prindi i akuzuarit raporton të akuzuarin për dhunë në familje, me rastin e arrestimit gjatë kontrollit të kryer në shtëpi është gjetur dhe sekuestruar substanca narkotike e llojit marihuanë dhe atë: 1 (një) qese plastike me substancë narkotike me peshë prej 2.83 gram, 3 (tri) qese plastike me substancë narkotike me peshë prej 4.80 gram, 1 (një) qese plastike me substancë narkotike me peshë prej 10.79 gram, 35 (tridhjetë e pesë) qese plastike me substancë narkotike me peshë prej 37.68 gram, 1 (një) peshore me ngjyrë të zezë me mbishkrim “Digital Scale” dhe 35 (tridhjetë e pesë) qese plastike të zbrazëta, të cilat substanca pas ekzaminimit dhe ekspertimit nga Laboratori i Agjencisë Kosovare për Forenzikë, me numër AKF/2023-3847/23-3738 të datës 31.01.2024, rezultojnë të jenë të llojit marihuanë me peshë të përgjithshme neto prej 45.75 gram.

Këso dore ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK).

Gjykata në bazë të nenit 7, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 79 dhe nenit 267 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK), të akuzuarin e:

G J Y K O N

- Për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK), shqipton dënimin nën kufirin e paraparë me ligj aplikon nenin 71 par.1 nën par.1.1 dhe 1.3 dhe nenin 72 par.1 nën par.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK), ashtu që i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë) muajve**, në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës 30.11.2023 gjerë me datën 09.02.2024 dhe me

- Dënimin me gjobë në lartësi prej **500 € (pesëqind euro)**, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me 25 (njëzet e pesë) ditë dënim burgu, duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

Të akuzuarit në pajtim me nenin 267 par.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074, i konfiskohen substancat narkotike dhe atë: 1 (një) qese plastike me substancë narkotike me peshë prej 2.83 gram, 3 (tri) qese plastike me substancë narkotike me peshë prej 4.80 gram, 1 (një) qese plastike me substancë narkotike me peshë prej 10.79 gram, 35 (tridhjetë e pesë) qese plastike me substancë narkotike me peshë prej 37.68 gram e që nga matjet del se substanca narkotike e llojit marihuanë është me peshë të përgjithshme neto prej 45.75 gram dhe 1 (një) peshore me ngjyrë të zezë me mbishkrim "Digital Scale" dhe 35 (tridhjetë e pesë) qese plastike të zbrazëta, pasi që janë mbajtur në kundërshtim me ligjin në fuqi.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

I akuzuari obligohet të paguaj 50 € (pesëdhjetë euro), në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Krimeve të Rënda, me datë 26.02.2024, ka ngritur aktakuzë nën numrin PP/I.nr.182/2023, ndaj të akuzuarit M.B., nga Prizreni, me numër personal 1244574641, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074. Ndërsa me datë 09.02.2024 në mes të prokurorit të shtetit, të akuzuarit M.B., dhe mbrojtësit të tij Avokat J.R., kanë lidhur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me numër PP/I.nr.182/2023, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 e cila marrëveshje është miratuar edhe nga ana e kryeprokurorit të shtetit.

Po ashtu në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë hartuar nga ana e prokurorit të shtetit, me pëlqimin e akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, kanë përcaktuar kushtet e pranimit të fajësisë, ku

në mes tjerash është negociuar dhe është propozuar dënimi për të akuzuarin. Në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074, në pikën nën II. është rekomanduar dënimi me gjobë prej 500 € (pesëqind euro) deri në 800 € (tetëqind euro) dhe dënimi me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj deri në 15 (pesëmbëdhjetë) muaj.

Në seancën dëgjimore **Prokurori i shtetit** theksoi se me datë 09.02.2024 ka lidhur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me të akuzuarin M.B., evidentuar me numër PP/I.nr.182/2023, ngase i akuzuari në marrëveshje ka hyrë me vullnet të plotë dhe i pa ndikuar nga askush, pasi që nga ana e prokurorit të shtetit është njoftuar për të drejtat që i takojnë në bazë të ligjit, kushtet, privilegjet dhe pasojat si dhe ka pasur hapësirë të mjaftueshme për konsultim me mbrojtësin e tij Avokat J.R., prandaj si rezultat i kësaj ka pranuar kushtet e ofruara nga ana e prokurorit të shtetit. Kjo marrëveshje po ashtu gjen mbështetje edhe në provat të cilat i përmban aktakuza, kështu që i akuzuari është pajtuar me dënimin e rekomanduar si në pikën II. të marrëveshjes dhe është pajtuar edhe me konfiskimin e sendeve të sekuestruara të cilat janë përshkruar në pikën III. të marrëveshjes. Prandaj duke pasur parasysh se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është lidhur në pajtim me dispozitat e nenit 230 të KPPRK, ka propozuar që e njëjta të aprovohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit **M.B., – Avokat J.R.,** theksoi pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe me vullnet të plotë është arritur kjo marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në mes të prokurorit të shtetit dhe akuzuarit, ku qëndron edhe dënimi i rekomanduar, propozoi gjykatës që marrëveshja të aprovohet ashtu që në kuadër të dënimit të rekomanduar të shqiptohet një dënim sa më i butë. I akuzuari M.B., pajtohet në tërësi me fjalët e mbrojtësit dhe nga gjykata kërkoi që t'i shqiptohet një dënim sa më i butë.

Ndër të tjera gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike. Ditën kritike me rastin e raportimit të dhunës në familje nga prindi i të akuzuarit Imer Beçiri, me datë 30.11.2023 rreth orës 21:30 minuta, në shtëpinë e tij e cila gjendet në rrugën “Suzi Qelebi” në Prizren, gjatë kontrollit të shtëpisë janë gjetur substanca narkotike dhe atë: substancë narkotike e llojit “marihuanë” me peshë 2.83 gram, tri (3) qese plastike me substancë narkotike të llojit “marihuanë” me peshë 4.80 gram, një (1) qese plastike me substancë narkotike të llojit “marihuanë” me peshë 10.79 gram, tridhjetë e pesë (35) qese plastike me substancë narkotike të llojit “marihuanë” me peshë 37.68 gram, të cilat substanca narkotike pas ekzaminimit dhe ekspertimit nga Laboratori i Agjencisë Kosovare për Forenzikë me numër AKF/2023-3847/23-3738 të datës 31.01.2024, rezultojnë të jenë të llojit “marihuanë” me matje neto me peshë të përgjithshme prej 45.75 gram. Po ashtu gjatë kontrollit janë gjetur 35 (tridhjetë e pesë) qese plastike të zbrazëta dhe një peshore me ngjyrë të zezë me mbishkrim “Digital Scale” të cilat janë përdorur me qëllim të matjes së substancës narkotike dhe paketimit të tyre. Kështu që i akuzuari pa autorizim dhe me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes ka poseduar substanca të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë dhe atë të llojit “marihuanë”. Me këto veprime i akuzuarit ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074.

Po ashtu këtë gjendje faktike gjykata ka vërtetuar nga përmbajtja dhe kushtet e pranimin të fajësisë, ku i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, kështu që gjykata, sipas detyrës zyrtare në pajtim me nenin 251 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës 08/L-032, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme e cila është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore, cila do të vente në dyshim dhe do të bënte të

papranueshme pranimin e fajësisë – marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Andaj gjykata konsideroi se nuk ekzistojnë rrethana të përcaktuara nga neni 248 të KPPRK, të cilat do të konsistonin në krijimin e situatës dhe rrethanave për hedhjen e aktakuzës.

Në seancën për shqyrtimin e marrëveshjes për pranim të fajësisë, gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, për veprën penale e cilat i vihen në barrë, me ç'rast nga ana e akuzuarit në mënyrë vullnetare është pranuar fajësia, pa kushtëzime, pa presione dhe askush nuk ka bërë premtim të kundërligjshëm i cili do të shtyjë në pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, por të gjitha këto janë bërë pas konsultës së mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe në harmoni me dispozitat e nenit 230, 241 dhe 242 të KPPRK. Gjukata gjithashtu nga i akuzuari ka vërtetuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka pranuar pa asnjë presion, me vullnet të plotë dhe heq dorë nga e drejta në gjykim të rregullt. Sa i përket vendimit mbi dënimin prokurori i shtetit i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, propozuan gjykatës që të aprovoj dënimin e përcaktuar në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

Gjukata ka marrë në konsideratë rrethanat të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, përcaktuar me nenin 69 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK), erdhi në përfundim se dënimi i propozuar nga palët, është dënim i cili i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit. Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga ana e akuzuarit, ku këtë gatishmëri të pranimit të fajësisë i njëjti ka shprehur që në fazat e hershme të procedurës dhe atë me lidhjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Andaj, bazuar në rrethanat e lartë theksuara, gjykata ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në tërësi me të gjitha pikat e saja, me ç'rast të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin e rekomanduar, ashtu që i shqiptoj dënimin me gjobë dhe me burgim e bindur se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, që i akuzuari në të ardhmen të jetë më i përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor gjykata morri në pajtim me nenin 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë në pajtim me nenin 36 par.3 nën par.3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Ligji 08/L-109.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
2023:264528 - 18.03.2024

Praktikantja
gjkues
Donita Osmanollaj

Kryetarja e trupit
Teuta Krusha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.